



Njoftim dhe ftesë për pjesëmarrje në Konferencën e Parë të Institutit Kombëtar të Fizikës

Instituti Kombëtar i Fizikës (IKF, www.ikf-akad.al), i cili është krijuar së fundmi dhe vepron në kuadër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, organizon Konferencën e tij të Parë me datat 10 - 11 Shkurt 2022.

Ky njoftim është ftesë për të gjithë fizikanët e interesuar që të aplikojnë dhe të marrin pjesë në këtë aktivitet.

IKF synon promovimin e dijeve më bashkëkohore dhe ekselencës në fushën e fizikës, në të gjithë hapësirën ku punojnë fizikanët shqiptarë, brenda dhe jashtë trojeve tona. Për këtë arsye, qëllimi i kësaj konference është promovimi i rezultateve të tyre kërkimore shkencore në sfondin e arritjeve më të fundit në fizikë, si dhe ngritja e një rrjeti bashkëpunimi mes tyre.

Zhvillimet bashkëkohore, në fizikë dhe në shkencat e ndërlidhura me të, shënojnë një hov të ndjeshëm vitet e fundit. Vërtetimet eksperimentale të teorive fizike si: vrojtimi i grimcës Higgs, i valëve gravitacionale, por edhe vrojtimi i shumë dukurive që nuk përcillen me një teori të plotë (p.sh. ai i materies së errët apo i energjisë së errët), dëshmojnë për gjallërinë e shkencës së fizikës në epokën tonë. Nga ana tjetër, nevojat dhe sfidat me të cilat ballafaqohet njerëzimi sot kërkojnë zgjidhje praktike, të cilat mbështeten në njohuri dhe rezultate që dalin nga studimet me bazë fizikë. Të tilla janë hulumtimet që kanë të bëjnë me shfrytëzimin efikas të burimeve energjetike, zhvillimin e qendrueshëm, mbrojtjen e mjedisit, apo edhe zhvillimin e metodave dhe instrumenteve të reja që mundësojnë matje të sakta e precize. Fizikanët shqiptarë janë ndjekës dhe kontribues të këtyre zhvillimeve, në bashkëpunim me kolegët e tyre në mbarë botën. Kështu, krijimi i një platforme ndërshqiptare bashkëpunimi, ku pikë lidhëse është kontributi në kulturën tonë, është një stad mjaft i dëshiruar, që shkon në interesin e të gjithë shqiptarëve.

Konferenca është e hapur për kontributin e gjithësecilit. Ajo do të shërbejë si një platformë njohjeje dhe zgjerimi të Institutit me anëtarë të rinj. Konferenca do të ketë vend për ligjërata plenare nga fizikanë të ftuar, shqiptarë ose jo, si dhe seanca paralele, të organizuara sipas specializimeve të ngushta të fizikës.

Ajo do të mbahet në formatin e përzier onsite dhe online, regjistrimi për pjesëmarrje do të jetë pa pagesë.



Gjuhët e komunikimit do të jenë Anglishtja dhe Shqipja. Konferenca mbahet në Tiranë, në mjediset e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Punimet e Konferencës do të kenë mundësi botimi në revistën e Akademisë së Shkencave JNTS (Journal of Natural and Technical Sciences). Për t'u regjistruar në Konferencë, ju ftojmë t'i drejtoheni faqes www.ikf-akad.al/konferenca-i-e-ikf (email: konferencaIKF@ikf-akad.al).

Afati i regjistrimit është 15 Dhjetor 2021.

Në emër të Bordit organizativ

Prof. Dr. Mimoza Hafizi, Acad. Assoc.

Drejtoreshë ekzekutive e IKF-së